



RAPORT TEKNIKE

OBJEKTI : RIKONSTRUKSION I BLOKUT TË
PALLATEVE “XHABIJE”

Punoi:
Ing. Gjon LASKA
Ark. IrmaTEMALI
Ark. Sandra LEKAJ

I. HYRJE

Mobilitet për jetesë më të mirë, krijimi i hapësirave më miqësore për një cilësi dhe siguri më të lartë është qëllimi i përgjithshëm i programit të bashkisë së re.

Rikualifikimi i mjediseve të përbashkëta dhe rikonstruksioni i shesheve dhe rrugëve, mbetet objektiv i punës edhe për vitet në vazhdim.

Konkretisht përmirësimi i kushteve të këtij sheshi konsiston në përmirësimin e mjedisit urban dhe në mënyrë të veçantë në kthimin në një shesh me standarte në shërbim të komunitetit. Ndërhyrja në rrjetin nëntokësor, rivlerësimi i ndriçimit rrit cilësinë dhe sigurinë e jetës së banorëve.

II. GJENDJA AKTUALE E OBJEKTIT

❖ Vendndodhja

Ky bllok pallatesh ndodhet në hyrje jugore të qytetit, kufizohet nga dy akset kryesore, Bulevardit "Zogu i I" dhe Bulevardit "Mehmet Pashe Plaku", me sipërfaqe totale të zonës 58940 m².





❖ Problematikat e infrastrukturës ekzistuese

Ky bllok pallatesh shtrihet në një zonë me sipërfaqe totale 58940 m². Kryesisht kemi ndërtime të tipit "pallat", që zhvillohen nga 3 deri në 5 kate, "banesa njëfamiljare" që zhvillohen nga 1 deri në 3 kate, si dhe objekte shërbimi kryesisht 1 katëshe.

Nga verifikimi në terren i gjithë zonës, rezulton se janë ndërtuar shumë shtesa, ndërtesa të tipeve të ndryshme, si dhe mure rrethuese të cilat kanë bllokuar rrugët e kalimit ndërmjet ndërtesave, duke penguar kështu qarkullimin si të këmbësorëve ashtu edhe të automjeteve.

Aktualisht në këtë bllok pallatesh mungon sistemi K.U.B, sistemi i ujit të pishëm pjesërisht si dhe rrjeti i ndriçimit. Ne pjesën më të madhe të bllokut rrjeti i KUZ egziston por ka problematika të shumta në mrefunksionimin e tij.

Në zonën e bllokut nga Bulevardi "Zogu I" në vite ka pasur një ndërhyrje asfaltimi me një shtresë pa përshfirë infrastrukturën nëntokësore. Si rrjedhojë e mungesës së KUB dhe ndërhyrjeve të ndryshme që ka pasur kjo pjesë e bllokut të banimit, është degraduar shtresa asfaltike.

Sipërfaqet e gjelbërta dhe ambientet rekreative janë shumë të pakta, në zona të ndryshme të bllokut mungojnë totalisht.



III. REALIZIMI I PROJEKTIT

❖ **Objektivi**

Ndërhyrja në këtë bllok pallatesh do të ndikojë në përmirësimin e mjedisit urban dhe në mënyrë të veçantë në kthimin në një shesh me standarte në shërbim të komunitetit. Ndërhyrja në rrjetin nëntokësor, rivlerësimi i ndriçimit si dhe hapja e akseve kryesore të kalimit, rrit cilësinë dhe sigurinë e jetës së banorëve.

❖ **Rradha e punimeve**

- Nga projektuesit do të hartohet projekti i rikonstruksionit të rrugëve, dokumentacionit teknik dhe skicat e plota për çdo segment dhe hapësirë publike.
- Investimi konsiston në kryerjen e ketyre punimeve:
 - Gërmimi i kasonetës së rrugës, gërmimi për ndërtimin e KUB, KUZ, linjën e ndriçimit dhe nivelimi i plotë i rrugës.
 - Sipas profileve gjatësor të hartuar nga topografi i firmës që do marrë përsipër kryerjen e punimeve në konsultim me ndërmarrjen e ujësjellës kanalizime qytet Shkodër për kuotat, do i jepet pjerrësia kanaleve kullues në drejtim të kolektorëve kryesor.
 - Kanalet e UB do të bëhen të mbyllur duke vendosur tuba të brinjëzuar HDPE d=315 mm.
 - Kanalet e UZ do të bëhen të mbyllur duke vendosur tuba të brinjëzuar HDPE d=200 mm dhe HDPE d=315 mm. Punimet do të kryhen mbas konsultimit me ndërmarrjen e ujësjellës kanalizime qytet Shkodër për kuotat e shkarkimit.
 - Linjat e ujësjellësit do të bëhen me tuba me diametër të ndryshëm sipas nevojave të rrjetit.
 - Do të ndërtohen linjat e reja të ndriçimit me 90 shtylla të cilat plotësojnë nevojat e zonës për ndriçim.
 - Mbjedhja e pemëve dhe e barit, si dhe vendosja e stolave të rinj.
 - Shtresë stabilizanti me trashësi mesatare 10 cm.
 - Shtresë binderi me zall lavatriçe, 4cm, me makineri.
 - Shtresë asfaltbetoni me zall lavatriçe, 3cm, me makineri.
 - Vendosja e sinjalistikës, vijëzimit dhe tabelave përkatëse.